




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLICA OF KOSOVA



Gjykata Themelore në Mitrovicë - dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjeve në Skenderaj, me gjyqtarin Gani Veseli dhe procesmbajtset Florie Gucati, duke vendosur në çështjen kundërvajtëse kundër të pandehurit, Ilaz Jakup Halili, nga fshati Kosterc, Komuna e Skenderajt, për shkak të kundërvajtjes të shkaktuar nga neni 17.al.1.pika 3 të Ligjit Antikorrupcion, Nr. 043/L - 50 të Republikës së Kosovës, lidhur me neni 9 dhe 10 të LMK-ës, si dhe në kuptim të nenëve 30,31,37,74,195, të Ligjit mbi kundërvajtjet, me dt.20.12.2013, mori:

A K T V E N D I M

I pandehuri: 1. Ilaz Halili, i lindur më 09.06.1964, në fshatin Kosterc,, i punësuar i martuar, me profesion : Fakultetin ekonomik, kushtet ekonomike të mesme , shqiptar - shtetas Kosovar.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse në muajin Mars të vitit 2012, zyrtari i Lartë Publik, nuk ka përmbushur obligimin Ligjor që parashihet me Ligjin 04/L-050, për deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zytrëve të lartë publik.Deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar , ku nuk ju kanë papërmbajtur nenit 9 të këtij Ligji.
Me këtë i pandehuri ka bërë kundërvajtje nga neni 17.al.1.pika 3 , të Ligjit mbi deklarimin e pasurisë..

D E N O H Ë T

ME DËNIM Qortimi për kundërvajtjen e shkaktuar nga neni 17 .al.1.pika 1 të Ligjit Antikorrupcion të Republikës së Kosovës.

I pandehuri ngarkohet me paushall gjuqësor në shumë prej 10 Euro, në kuptim të nenit 109.al.1.pika 6 të LMK-ës, pagesa e kësaj shume bëhet në arkën e kësaj gjykate në afatin prej 15 ditësh pasi që vendimi të merr formën e prerë.
Nga një kopje e këtij Aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit .

A r s y e t i m i

Agjensioni Antikorrupcion, ushtroi kërkesën e vet, nr.01-2513/12 të dt.13.07.2012, me qëllim të hapjes dhe zhvillimit të procedurës kundërvajtëse , kundër të pandehurit të Lartëtheksuar , për kundërvajtjen e shkaktuar nga neni 17.al.1.pika 3 të Ligjit Antikorrupcion .

Gjykata pas shqimit të kërkesës të ushtruar nga ana Agjencionit Antikorrupcion, konstatoi se kërkesa I plotëson kushtet për zhvillimin e procedurës.Gjykata mori Konkluzion mbi zhvillimin e procedurës kundërvajtëse me dt. 27.02.2013 dhe caktoi senacën e shqyrtimit për dt. 16.10.2013, ndërsa në pyetje u muar me dt.16.12.2013, dhe në mbrojtjen e tij i pandehuri shtoi: Është e vërtetë se unë në muajin Mars nuk e kam mbushur aplikacionin e agjencionit antikorrupcion për paurinë time, por jo pse nuk kam dashur ta bëjë këtë , por për shkak se kam patur probleme familjare dhe kam qenë jashtë vendit për shkak se kam patur probleme shëndetësore me grua – në Gjermani dhe kur jam kthyer e kam kryer këtë obligim. Provë vërtetimin nga agjencioni antikorrupcion për përmbushjen e detyrimit në muajin Prillë. Prova mbetet në shkrerat e lëndës.

Gjykata pas shqimit dhe vlerësimit të provave në shkrerat e lëndës si dhe nxjerrjes së provave në procedurë, erdhi në përfundim se i pandehuri Ilaz nuk kishte përmbushur obligimin ligjor-deklarimin e pasurisë përmes aplikacionit ta Agjencionit Antikorrupcion për muajin Mars të vitit 2012. Këtë obligim e ka përmbushur pas afatit të paraparë me Ligj, me dt. 26.04.2012. Prandaj me këtë i njëjti ka bërë veprë kundërvajtëse – mospërmbushje të detyrimit në afatit ligjor për deklarimin e pasurisë . Për veprën kundërvajtëse të shkaktuar i njëjti mbanë përgjegjësi ligjore dhe Gjykata mu për këtë , të njëjtin e shpalli fajtor duke i shqiptuar një dënim qortimi në kuptim të nenëve 17.al.1. pika 3 ,lidhur me neni 9 dhe 10 të LMK-ës.

Gjykata ndaj të pandehurit aplikoi nenet 9 dhe 10 të LMK-ës për zbutje të jashtëzakonshme dhe dënim Qortimi, për shkak se i pandehuri veprën kundërvajtëse nuk e ka bërë me qëllim, por kjo ka qenë si pasojë që i njëjti nuk ka qenë në gjendje të kryej detyrimin, për shkaqe objektive . Gjykaa mori përbazë arsyetimin –gjegjësishhtë mbrojtjen e të pandehurit se i njëjti ka qenë në vështirësi dhe nuk ka mundur ta bëjë deklarimin e pasurisë me kohë.

Prandaj, Gjykata mendon se dënim i shqiptuar do ta arrijë qëllimin e vet dhe se është i mjaftueshëm për peshën e përgjegjësise për veprën kundërvajtëse të kryer.


Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit mori parasyshë rrethanat lehtësuese dhe rënduese nda, të pandehurit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Gjykata Themelore në Mitrovicë- dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni i Kundërvajtjeve në Skenderaj.

Skenderaj, më dt.20.12.2013.

Këshilla Juridike: Kundër këtij Aktvendimi i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës kanë të drejtë ankese , në afatin prej 8 ditësh, pas marrjes së këtij Aktvendimi , Gjykatës së Apelit, Departamentit të përgjithshëm – Divizionit të kundërvajtjeve Në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate



Gjyqtari,
Gani Veseli